



Pranuar / Dorezuar Received / Delivered	06.09.2023	3	viti god Year
Organ / Institucia Org / Unit	Nr. Prot Pr. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHMYSHICK	5998/2023		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1036/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca Arben Mehmeti, anëtarë; me Sabile Avdyli, zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1036/2023, të datës 27.07.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted] nga Mitrovica, kundër organit të punësimit: Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1; nenin 16 ,paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 06.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1036/2023, e datës 27.07.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.01/2023, i datës 19.07.2023, i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] (me tej referuar ankuesi), me datë 27.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.1036/2023, kundër Vendimit Nr.02/2023, të datës 10.07.2023 dhe Vendimit Nr.1/2023, të datës 19.07.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me pretendimet ankimore se me refuzimin e aplikacionit sipas vendimeve të kundërshtuara, ankuesit i është cenuar e drejta për të qenë kandidat i mundshëm për pozitën e punës “inspektor i arsimit” i shpallur sipas Konkursit me numër të referencës RN00011610.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës(tutje Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamenti për Menaxhimin e

Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit më datë 04.08.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptime të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5386/2023 të datës 27.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër të referencës RN00011610, të datës 05.05.2023; Vendimin me Nr.02/2023 të datës 10.07.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Ankesën e ankuesit të datës 12.07.2023 e parashtruar të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Komunikimin elektronik të datës 13.07.2023 ndërmjet ankuesit dhe zyrtarëve të DMZP-së, Dëshmi lidhur me rezultatet e verifikimit paraprak për refuzimin e aplikacionit të ankuesit të datës 11.07.2023; Vendimin me Nr.01/2023 të datës 19.07.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Diplomën e ankuesit me numër Nr.2023 të datës 14.04.2012, të Universitetit të Prishtinës-Fakulteti Filozofik; Diplomën e ankuesit me numër Nr.1395 të datës 28.10.2019 nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filozofik; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.08.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 04.08.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës: Aplikacionin e ankuesit të datës 02.06.2023 së bashku me dëshmitë e bashkangjitura si në vijim: Licencën e mësimdhënësit me Nr.1030917 të datës 08.03.2022 nga MASHT, Certifikatën e muajit maj të vitit 2022 të lëshuar nga MASHT për përfundim të trajnimit, Vërtetimin me Nr.Prot.45 të datës 26.05.2023 të lëshuar nga Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Jashar Begu" lidhur me përvojën e punës; Kopjen e letërnjoftimit; Certifikatën e datës 25.05.2023 mbi dënimet penale nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar e gjeneruar nga SIMBNJ; Njoftimin e datës 10.07.2023 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Njoftimin e datës 19.07.2023 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si dhe Vendimin me Nr.05/51 të datës 12.07.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me formimin e Komisionit për Institucionet e Administratës Shtetërore.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me datë 05.05.2023, ka publikuar në sistemin elektronik-SIMBNJ, Konkursin për praninë, me numër reference RN00011610, për emrin e grupit Specialistë të Arsimit, titulli i vendit të punës "Inspektor i Arsimit", SIA në Mitrovicë, klasa profesional 1, tri (3) vende. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 26.05.2023 deri me datë 05.06.2023, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi më datë 02.06.2023.

Në fazën e shqyrtimit paraprak, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me Vendimin Nr.02/2023, të datës 10.07.2023, ka refuzuar aplikacionin e ankuesit, me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi lidhur me kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit (diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve) ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Ankuesi i pakënaqur me refuzimin e aplikacionit, me datë 12.07.2023, ka parashtruar ankesë pranë Njesisë Përgjegjëse përkatësisht Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, e cila me Vendimin Nr.1/2023 të datës 19.07.2023, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar, më arsyetimin se në aplikacionin e të njëjtit mungon diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Në funksion të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore referuar procedurës dhe kushteve të pranimit të nëpunësve civilë, përkatësisht:

- Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, ku me nenin 34 përcaktohet: 1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 3. Konkurrimi organizohet nga DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim: njësia përgjegjëse). 4. Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 21 ditë, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Afati për pranimin e aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 dite dhe jo më i gjatë se 15 ditë kalendarike. 5. Shpallja e konkursit, sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfshin përshkrimin e përgjithshëm të punës për grupin përkatës, pozitat e punës të lira në grupin përkatës, kriteret që duhet t'i plotësojnë kandidatët, afatin për aplikim, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e procesit të përzgjedhjes dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim. 6. Konkurrimi zhvillohet në dy faza: 6.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6.2. vlerësimi i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 7. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i pranimit (në vijim: Komisioni i pranimit), i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë për të cilin zhvillohet konkurrimi....

-Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku neni 10 parasheh se : 1. Shpallja e konkurimit për një Grup të caktuar përmban, të paktën, këto të dhëna: 1.1. përshkrimin e përgjithshëm të punës së Grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 1.2. Kërkesat e përgjithshme për pranim sipas nenit 8 të LZP; 1.3. kërkesat e përgjithshme formale; 1.4. njohuritë, aftësitë dhe cilësitë që vlerësohen në procedurën e konkurimit (kërkesat e përgjithshme të nevojshme); 1.5. listën e pozitave, aktualisht të lira, të Grupit për të cilin zhvillohet konkurimi; 1.6. mënyrën për paraqitjen e aplikacioneve; 1.7. afatin përfundimtar për pranimin e aplikacioneve të përcaktuara me datë të saktë kalendarike; 1.8. dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikacionit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre; 1.9. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve; 1.10. mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët..." 2. Të gjitha shpalljet e konkurimit, gjithashtu, përmbajnë këto shënime: 2.1. "Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj"; 2.2. "Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen"; 3. Kushtet për aplikim, në pajtim me paragrafin 1, nënparagrafin 1.2 të këtij neni, përfshijnë kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë në pajtim me nenin 8 të Ligjit dhe kërkesat e veçanta të pranimit në Grupin për të cilin zhvillohet konkurimi, të përcaktuara sipas dispozitave të Rregullores për klasifikimin e punëve në shërbimin civil. 4. Të gjitha dokumentet e dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e konkurimit, kandidati, përmes aplikacionit, vetdeklaron se janë të vërteta dhe mban përgjegjësi për

vërtetësinë e tyre. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkak për përjashtimin nga procedura e pranimit. Neni 12 përcakton se: **Përmbajtja e aplikacioneve** 1. Aplikacioni përmbanë këto të dhëna: 1.1. një referencë në shpalljen e konkurimit; 1.2. të dhënat personale të kandidatit; 1.3. nivelin e arsimit si dhe diplomat e fituara, institucionet arsimore, datat e diplomimit; 1.4. një përshkrim të hollësishëm të përvojës së punës, duke përfshirë: emrin e punëdhënësit, funksionet, titujt, rangjet, kohëzgjatja e punës, një përshkrim i shkurtër i detyrave, numri dhe lloji i personelit nën mbikëqyrje, adresa e punëdhënësit, arsyet për largimin nga vendi i punës; 1.5. njohuritë gjuhësore; 1.6. informata mbi trajnimet e veçanta të kryera, kualifikimet profesionale dhe specializimet, aftësitë e veçanta dhe publikimet; 1.7. njohuritë kompjuterike; 1.8. emri, adresa dhe numri i kontaktit të dy (2) personave referues; 2. **Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurimit, kandidatët duhet të bashkangjitin edhe dokumentacionin si në vijim:** 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion. Neni 14 përcakton se: Neni 14 Fazat e konkurrimit 1. Konkurrimi për pranimin në shërbimin civil, përfshin dy faza: 1.1. Verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. Vlerësimi i kandidatëve. Neni 15 përcakton se: 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë. 4. Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për aplikim renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 5. Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6. Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashitohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj.

Në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar Konkursin me numër reference RN00011610, për emrin e grupit Specialistë të Arsimit, titulli i vendit të punës "Inspektor i Arsimit", ku sipas pikës 3, si i kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: - **Arsimi:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve; - **Licencë** e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës **Përvoja e punës:** Së paku dy vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës, me theks të veçantë, përvojë punë në mësimdhënie, ndërsa sipas pikës 7 të konkursit, dokumentacione për aplikim janë specifikuar: - **Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimi për diplomat e marra jashtë vendit;** - **Kopje e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet se paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim:** pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale; - **Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;** - **Certifikatë/vërteti nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit.** - Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojë e kërkuar e punës, është në sektorit publik atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilën

dëshimohet se ai/ajo nuk gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.6) të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë”.

Në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur së ankuesi përkitazi me kriterin e arsimit, ka dorëzuar më rastin e aplikimit vetëm Diplomën me Nr.1395, të datës 28.10.2019, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshimohet se i njëjti me datë 18.10.2019, ka mbaruar studimet e nivelit master, në Fakultetin Filozofik – Departamenti i Historisë, mirëpo, i njëjti nuk ka bashkangjitur dëshmi lidhur me përfundimin e studimeve themelore (diplomën e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve). Gjegjësisht, ankuesi diplomën e studimeve tre vjeçare themelore, e ka dërguar të njësia përgjegjëse vetëm me rastin e parashtrimit të ankesës më datë 12.07.202, të parashtruar kundër vendimit Nr.02/2023 të datës 10.07.2023, për refuzim të aplikacionit të ankuesit. Andaj, mbi këtë bazë të konstatimit, Kolegji vlerëson së janë të pa bazuar pretendimet ankimore të ankuesit, dhe si rrjedhojë njësia përgjegjëse në këtë rast Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me rastin e nxjerrjes së vendimeve të goditura me ankesë ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 10 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 ku përcaktohet se: “Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”; nenin 12 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 ku theksohet se: Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurimit, kandidatët duhet të bashkangjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore;... si dhe nenin 15 paragrafi 5 ku përcaktohet se: 5. “Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin”.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1036/2023

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB dhe
- Arkiviot të KPMSHCK-së.

